

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **OPŠTINA SEVERNA MITROVICA/ KOMUNA E MITROVICËS SË VERIUT**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **2026/647-26-2891-5-2-1**

Sa i përket tenderit për: **“Ndërtimi i rrugës, parkingut dhe krijimi i sipërfaqeve të gjelbëruara në rrugën Vasilije Ostrovski” në Mitrovicën Veriore**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

ETEA SH.P.K.

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Millosevë, Obiliq

(Adresa)

Obiliq

(Vendi)

049/396874

(Numri Telefonit)

15050

(Kodi postar)

N/A

(Numri i Faks-it)

Drilon Etemi

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

eteamshpk@gmail.com

(Adresa elektronike)

13.07.2026

(Data e parashtrimit të kërkesës)



(Nënshkrimi dhe vula)

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Avokat Qëndrim Arifi
(Emri i avokatit)


Rr. "Idriz Gjilani", Llamela 15, Kati 2, Nr. 213, Dardani, Prishtinë.
(Adresa e plotë)

+383 49 875 852
(Numri i Telefonit)

avokatura.ap@gmail.com
(Adresa elektronike)

13.07.2026
(Data e parashtrimit të ankesës)

N/A
(Numri i faks-it)



(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs të projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi për kontratë – 30.04.2026
Afati i fundit për dorëzimin e tenderëve – 26.05.2026
B58 – Njoftimi mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues – 24.06.2026
Kërkesa për Rishqyrtim-29.06.2026
Vendimi për refuzimin e Kërkesës për Rishqyrtim – 02.07.2026

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒

Jo ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

OE ETEAM SH.P.K. më 29.06.2026 paranë AK-së ka parashtruar Kërkesë për Rishqyrtim, me pretendimin se kundërligjshëm është rekomanduar për kontratë OE Rexha SH.P.K., ndërsa ka argumentuar në mënyrë shterruese se oferta e ETEAM SH.P.K. është oferta e vetme e përgjegjshme në këtë aktivitet të prokurimit.

AK më 02.07.2026 ka refuzuar Kërkesën për Rishqyrtim, duke mos dhënë anjë bazë faktike apo ligjore e cila mbështet vendimin e saj të datës 24.06.2026, prandaj të shtyrë nga kjo qasje e AK-së ne jemi detyruar që të kërkojmë mbrojtje ligjore pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 i LPP-së
Neni 6 i LPP-së
Neni 7 i LPP-së
Neni 52 i LPP-së
Neni 59 i LPP-së
Neni 4 i RrPP-së
Neni 19.11 i RrPP-së
Neni 26.14 i RrPP-së
Neni 27.3 i RrPP-së
Neni 40.6, 40.13, i RrPP-së
Neni 45.17, 45.18, i RrPP-së
Neni 62.2 i RrPP-së

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Rrjedha e procedurës:

1. ETEAM SH.P.K. më datë 26.05.2026, në përputhje me Njoftimin për Kontratë të Autoritetit Kontraktues (tutje referuar si AK) Komuna e Mitrovicës së Veriut, ka dorëzuar ofertën e tij për aktivitetin e prokurimit me titull: **“Ndërtimi i rrugës, parkingut dhe krijimi i sipërfaqeve të gjelbëruara në rrugën Vasilije Ostrovski” në Mitrovicën Veriore**”, me numër të prokurimit: 2026/647-26-2891-5-2-1.
2. Në po të njëjtën datë, AK ka publikuar Procesverbalin e Hapjes së Tenderëve, nga i cili rezulton se për këtë aktivitet të prokurimit janë pranuar vetëm dy oferta, konkretisht oferta e ETEAM SH.P.K. në vlerë prej 49,939.83 euro dhe oferta e OE Rexha SH.P.K., në vlerë prej 46,807.49 euro.
3. AK më 24.06.2026 ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin e AK-së me të cilin si fitues shpallë OE-në Rexha SH.P.K., ndërsa ofertën tonë e konsideron si të pasuksesshme.

Nr.	Emri dhe adresa Operatorëve Ekonomik pjesëmarrës	Vlera totale e ofertave ²
1.	Rexha, Kroi i Bardhë Lam.A Nr. I Nr.107, 10000, PRISHTINË, Kosovë	46,807.49 EUR
2	ETeam SH.P.K., Obiliq, 15050, Rruga e Llapit PN, Milloshevë, Kosovë	49,939.83 EUR

Komuna e Mitrovicës Veriore shpërblen me kontratë Rexha, Kroi i Bardhë Lam.A Nr. I Nr.107, 10000, PRISHTINË, Kosovë në vlerë totale të ofertës 46,807.49 (dyzet e gjashtë mijë e tetëqind e shtatë euro e dyzet e nëntë cent.

4. Në po të njëjtën ditë, pranë AK-së kemi parashtruar kërkesë për qasje në ofertën e OE-së të shpallur fitues, ndërsa pas analizimit të dokumenteve rezulton qartë se OE Rexha SH.P.K. qartësisht është i papërgjegjshëm, dhe në fakt i njëjti është dashur të eliminohet nga gara, ndërsa për kontratë të rekomandohet OE ETEAM SH.P.K.
5. Si rezultat i mospajtimit me Vendimin e AK-së të datës 24.06.2026, ne më 29.06.2026 pranë AK-së kemi parashtruar Kërkesë për Rishqyrtim.

6. Në këtë Kërkesë ne kemi parashtruar katër (4) pretendime ankimore, AK në vendimin për refuzimin e Kërkesës për Rishqyrtim, nuk ka argumentuar në mënyrë bindëse, të bazuar në ligj dhe në gjendjen faktike asnjë nga pretendimet tona. Andaj pretendimet tona të paraqitura në Kërkesën për Rishqyrtim mbesin të qëndrueshme dhe vërtetojnë se oferta e OE Rexha SH.P.K. është e papërgjegjshme.
7. OE ETEAM SH.P.K. i pakënaqur me këtë vendim të AK-së i cili refuzimin e pretendimeve tona nuk e bazon në kërkesa të Dosjes së Tenderit dhe dispozita ligjore, pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit paraqet këtë ankesë.
8. Në vazhdim po i parashtrojmë pretendimet tona:

Pretendimi 1: OE i rekomanduar Licencën për inxhinierin e gjeodezisë e ka ofruar në kundërshtim me kërkesat e Dosjes së Tenderit

AK në kuadër të Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale ndër tjerash ka kërkuar edhe: **“1 (një) inxhinier i diplomuar (bachelor ose master) i gjeodezisë i licensuar me licensë valide A ose B mbi 3 vite përvojë pune”.**

diplomuar (bachelor ose master) i ndërtimtarisë i licensuar me licensë valide A ose B mbi 3 vite përvojë pune, 1 (një) inxhinier i diplomuar (bachelor ose master) i gjeodezisë i licensuar me licensë valide A ose B mbi 3 vite përvojë pune, 1 (një) inxhinier i diplomuar (bachelor ose master) i makinerisë i licensuar me licensë valide A ose B mbi 3 vite përvojë pune. Kërkesën per listën e pajisjeve e gjeni në Aneksin nr 7 në dosjen e tenderit.


Nga shqyrtimi i ofertës së Operatorit Ekonomik të rekomanduar për kontratë, Rexha SH.P.K., rezulton se për përmbushjen e kësaj kërkesë është propozuar gjeodeti z. Arban Grajçevci, mirëpo dokumentacioni i paraqitur për të njëjtin nuk është në përputhje me kërkesën e përcaktuar në Dosjen e Tenderit.

Konkretisht, AK ka kërkuar posedimin e një licence valide të kategorisë "A" ose "B", ndërsa Operatori Ekonomik i rekomanduar ka bashkëngjitur një licensë të lëshuar nga Agjencia Kadastrale e Kosovës, e cila nuk përmban dhe nuk kategorizon licencat sipas kategorive "A" ose "B", siç është kërkuar shprehimisht nga Dosja e Tenderit.


Për më tepër, nga praktika e vetë ofertës së Operatorit Ekonomik të rekomanduar rezulton se, për profilet e tjera profesionale, ai ka paraqitur licenca të lëshuara sipas kategorive të kërkuara nga Dosja e Tenderit. Për shembull, për stafin tjetër profesional janë ofruar licenca përkatëse në përputhje me kërkesat e AK-së, ndërsa për pozitën e inxhinierit të gjeodezisë mungon një licensë e tillë.

Për shembull OE Rexha SH.P.K. për inxhinierin e ndërtimtarisë ka ofruar licensë për stafin Arben Selimi (Inxhinier i Makinerisë) në përputhje të plotë me kërkesat e dosjes së tenderit, ndërsa për inxhinierin e gjeodezisë i mungon një licensë e tillë.

Më poshtë po i ilustrojmë licencat për inxhinierin e ndërtimtarisë që është në përputhje me Dosjen e Tenderit dhe atë për inxhinierin e gjeodezisë që është në kundërshtim me kërkesat e dosjes:



Licencë sipas kërkesave të DT-së



Licencë në kundërshtim me kërkesat e DT-së

Çështja e licensimeve sipas kategorive “A” dhe “B” është e rregulluar sipas Rregullores për procedurën e licensimit, rilicensimit, mirëmbajtjen, pezullimin dhe revokimin e licencës së inxhinierit të licensuar të odës, konkretisht neni 5 i kësaj rregullore.

Në këtë rast, është me rëndësi të theksohet se Oda e Inxhinierëve të Republikës së Kosovës (OIRK) është institucioni kompetent që administron dhe lëshon licencat profesionale sipas kategorive përkatëse, përfshirë kategoritë "A" dhe "B", të cilat janë kërkuar në Dosjen e Tenderit. Në ueb-faqen zyrtare të OIRK-së <https://oirk.org>, mund të verifikohet regjistri i inxhinierëve të licensuar, konkretisht duke klikuar në këtë link: <https://oirk.org/wp-content/uploads/2026/06/Regjistri-i-licencave-te-leshuara-OIRK-1.pdf>

Gjithashtu, nga verifikimi i regjistrit publik të licencave të lëshuara nga OIRK, rezulton se emri i z. Arban Grajçevci nuk figuron në listën e inxhinierëve të licensuar me licencë të kategorisë "A" ose "B", siç është kërkuar nga AK, ndërsa në këtë listë janë dhjetra inxhinier të gjeodezisë të licensuar, përfshirë edhe inxhinieren e propozuar nga ETEAM SH.P.K. znj. Donika Bytyçi.

Për rrjedhojë, Operatori Ekonomik i rekomanduar nuk ka dëshmuar përmbushjen e një kërkesë të qartë dhe të detyrueshme të Dosjes së Tenderit, përkatësisht disponimin e një inxhinieri të gjeodezisë të licensuar me licencë valide të kategorisë "A" ose "B". Duke qenë se kërkesat e Dosjes së Tenderit janë detyruese dhe duhet të plotësohen në tërësi nga të gjithë operatorët ekonomikë në mënyrë të barabartë. Prandaj si rezultat i kësaj, oferta e OE Rexha SH.P.K. është dashur të vlerësohej si e papërgjegjshme dhe, si e tillë, të mos rekomandohej për dhënie të kontratës.

AK në përgjigjen ndaj Kërkesës për Rishqyrtim, është munduar të justifikoj licencën e gjeodetit të ofruar nga OE i rekomanduar, konkretisht ka theksuar se: *“Autoriteti Kontraktues ka kërkuar licence valide për ushtrimin e veprimtarisë profesionale në fushën e gjeodezisë. Licenca e leshuar nga Agjencia Kadastrale e Kosovës (AKK) Eshtë dokument zyrtar dhe i vlefshëm për ushtrimin e kësaj veprimtarie dhe permbush kërkesat e dosjes së tenderit. Megjithëse operatori ekonomik ka të drejtë të paraqesë licencë të kategorisë A ose B, licenca e leshuar nga Agjencia Kadastrale e Kosovës konsiderohet me kompetente dhe më relevante për ushtrimin e veprimtarive të gjeodezisë dhe si e tillë është pranuar si e vlefshme”*.

Ky arsyetim i AK-së nuk qëndron, pasi me Dosjen e Tenderit nuk është kërkuar në mënyrë të përgjithshme një licencë valide për ushtrimin e veprimtarisë së gjeodezisë, por është kërkuar shprehimisht "licencë valide A ose B".

Për rrjedhojë, AK nuk ka pasur të drejtë që gjatë fazës së vlerësimit të pranojë një lloj tjetër licence, e cila nuk përmban kategorizimin "A" ose "B", pavarësisht se nga cili institucion është lëshuar. Vlerësimi i ofertave duhet të bëhet në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Dosjen e Tenderit dhe jo mbi bazën e një vlerësimi subjektiv se një licencë është "më kompetente" apo "më relevante".

Për më tepër, nga regjistri publik i OIRK-së rezulton se ekzistojnë dhjetra inxhinierë të gjeodezisë të licencuar me licencë të kategorisë "A" ose "B", çka dëshmon se kërkesa e AK-së ka qenë e realizueshme dhe duhej të plotësohej nga të gjithë operatorët ekonomikë në mënyrë të barabartë.

Prandaj, OE i rekomanduar nuk ka dëshmuar përmbushjen e kërkesës së qartë dhe detyruese të Dosjes së Tenderit lidhur me licencën e inxhinierit të gjeodezisë, dhe oferta e tij është dashur të vlerësohej si e papërgjegjshme.

Është shumë e rëndësishme të theksohet se: AK në një aktivitet tjetër të inicuar më 11.06.2026, me titull: “Rregullimi i rrugës Nezir Zasella” në Mitrovicën Veriore”, me numër të prokurimit 2026/647-26-4540-5-2-1, në kuadër të kërkesave mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale ndër tjerash ka kërkuar gjithashtu edhe: “1 (një) inxhinier i diplomuar (bachelor ose master) i gjeodezisë i licensuar me licensë valide A ose B mbi 3 vite përvojë pune”. Ndërsa pas Kërkesës sonë për Rishqyrtim, pra me të parë dhe kuptuar se kërkesat e Dosjes së Tenderit duhet të respektohen në përpikëri, atëherë AK nëpërmjet Formularit Standard të publikuar më 02.07.2026 ka ndryshuar kërkesat lidhur me inxhinierin e diplomuar të gjeodezisë duke larguar kategorinë “A” dhe “B” të cilat kategori i lëshon vetëm OIRK.

Pra, kjo e argumenton qartë pretendimin tonë se përderisa kërkesë e Dosjes së Tenderit ka qenë licencë valide “A” ose “B”, dhe përderisa kjo kërkesë nuk është sfiduar ligjërisht gjatë procedurave paraprake (nëpërmjet Kërkesës për Rishqyrtim kundër Njoftimit për Kontratë), atëherë respektimi në përpikëri i kërkesave të Dosjes së Tenderit përveç që bëhet obligim, në të njëjtën kohë çdo devijim, apo bishtërim do të përbënte diskriminim për operatorë tjerë në garë, mirëpo edhe për operatorët të cilët potencialisht vetëm që nuk kanë mundur të sigurojnë licencë të kategorisë “A” ose “B” nuk kanë ofertuar fare në këtë aktivitet.

Pretendimi 2: Pompa e ujit e ofruar nga OE i rekomanduar nuk dëshmohet se i përmbush kërkesat e Dosjes së Tenderit

Në Dosjen e Tenderit, Autoriteti Kontraktues ka kërkuar që operatorët ekonomikë të disponojnë, ndër të tjera, edhe **“një pompë uji me kapacitet 3 hp, me motor diesel”**.

OE "Rexha" SH.P.K., për të dëshmuar përmbushjen e kësaj kërkesë ka dorëzuar një faturë blerjeje për dy pompa uji të lëshuara nga kompania R.U.B. SH.P.K.. Megjithatë, nga dokumenti i paraqitur nuk rezultojnë të dhëna të mjaftueshme teknike që do të mundësonin verifikimin e përputhshmërisë së pajisjeve me kërkesat e përcaktuara në Dosjen e Tenderit.

Konkretisht, në faturën e dorëzuar nuk janë të specifikuara karakteristikat teknike thelbësore të pompës së ujit, përkatësisht fuqia prej 3 hp dhe lloji i motorit (diesel). Për rrjedhojë, nga dokumentacioni i paraqitur nuk mund të konstatohet në mënyrë të qartë dhe të pakontestueshme se pajisja e ofruar i përmbush kriteret e kërkuara nga Autoriteti Kontraktues.

Për rrjedhojë, vlerësojmë se Autoriteti Kontraktues nuk ka pasur bazë për të konstatuar përmbushjen e kësaj kërkesë dhe, si pasojë, nuk është dashur ta rekomandojë për dhënie të kontratës operatorin ekonomik "Rexha" SH.P.K.

Përgjigja e AK-së përderisa refuzon këtë pretendim: AK në përgjigje kundër pretendimit tonë ankimor ka theksuar se çështja e ngritur nga ne nuk është e rëndësishme, konkretisht ndër tjerash thekson se: *“Ky aktivitet prokurimi ka per objekt ndërtimin e rrugëve, ku pajisjet kryesore kritike për realizimin e kontratës janë makineritë e rënda rrugore, ndërsa pompa e ujit përbën një pajisje ndihmëse operative. Refuzimi i ofertës vetëm për shkak se ne faturën e pompës së ujit nuk është shënuar numri i kuajve fuqi (HP), ndonëse pajisja është paraqitur dhe nuk vihet ne dyshim ekzistenca e saj, përbën një formalizëm të tepruar.....”*.

Arsyetimi i AK-së jo vetëm që nuk e rrëzon pretendimin tonë ankimor, por në fakt konfirmon se gjatë vlerësimit të ofertave nuk janë zbatuar kërkesat e përcaktuara në Dosjen e Tenderit.

Autoriteti Kontraktues pranon se dokumentacioni i paraqitur nga OE "Rexha" SH.P.K. nuk përmban të dhënat teknike të kërkuara, përkatësisht kapacitetin prej 3 hp dhe llojin e motorit diesel, por arsyeton se kjo kërkesë përbën një pajisje "ndihmëse operative" dhe se mosplotësimi i saj nuk duhet të çojë në refuzimin e ofertës. Një arsyetim i tillë është në kundërshtim me parimet themelore të prokurimit publik.

Autoriteti Kontraktues, pasi ka vendosur vetë në Dosjen e Tenderit kërkesën për posedimin e "një pompe uji me kapacitet 3 hp, me motor diesel", nuk ka të drejtë që në fazën e vlerësimit ta konsiderojë këtë kërkesë si jo materiale apo dytësore. Nëse një kërkesë është përcaktuar si kriter i detyrueshëm në Dosjen e Tenderit, atëherë ajo duhet të përmbushet dhe të verifikohet në mënyrë të barabartë për të gjithë operatorët ekonomikë.

Pikërisht pranimi i një dokumenti nga i cili nuk mund të verifikohet përmbushja e kërkesës teknike përbën shkelje të parimit të trajtimit të barabartë, transparencës dhe proporcionalitetit, sepse i bije se AK ka hequr dorë nga një kriter që vetë e ka vendosur. Autoriteti Kontraktues nuk mund të ndryshojë, zbusë apo relativizojë kërkesat e Dosjes së

Tenderit pas hapjes së ofertave, duke vlerësuar subjektivisht se cilat kërkesa janë “të rëndësishme” dhe cilat jo.

Për rrjedhojë, AK nuk ka pasur bazë faktike dhe juridike për të konstatuar se OE "Rexha" SH.P.K. ka përmbushur kërkesën për posedimin e një pompe uji me kapacitet 3 hp dhe motor diesel, dhe si rezultat oferta e këtij operatori nuk është dashur të konsiderohet e përgjegjshme.

Pretendimi 3: Dyshime serioze lidhur me autenticitetin dhe vlefshmërinë e dokumentacionit të paraqitur për pajisjen “Sinjalizues digjital me sensor, lëvizës për rregullimin e komunikacionit”

Në kuadër të kërkesave të Dosjes së Tenderit, Autoriteti Kontraktues ka kërkuar që operatorët ekonomikë të disponojnë **“dy (2) sinjalizues digjitalë me sensor, lëvizës për rregullimin e komunikacionit”**.

Për të dëshmuar përmbushjen e kësaj kërkesë, operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë ka paraqitur një faturë blerjeje të lëshuar, sërisht, nga kompania R.U.B. SH.P.K.. Megjithatë, nga analiza e kësaj fature rezultojnë mospërputhje dhe parregullsi serioze, të cilat krijojnë dyshime të arsyeshme lidhur me autenticitetin dhe vlefshmërinë e saj.

Konkretisht, në faturën e paraqitur figuron data e lëshimit 10.07.2018, ndërsa numri i faturës është i evidentuar si 135/2016. Kjo mospërputhje ndërmjet vitit të lëshimit të faturës dhe vitit të reflektuar në numrin e saj ngre dyshime serioze mbi rregullsinë dhe besueshmërinë e dokumentit të paraqitur. Në mungesë të një shpjegimi apo dokumentacioni shtesë, mbetet e paqartë se si mund të lëshohet në vitin 2018 një faturë me numeracion që i referohet vitit 2016.

Për më tepër, fatura në fjalë nuk përmban elementet themelore dhe të domosdoshme që zakonisht duhet t'i përmbajë një dokument i tillë financiar, duke përfshirë, ndër të tjera, edhe të dhënat lidhur me TVSH-në, gjë që shton edhe më tej dyshimet mbi vlefshmërinë e saj.

Për ilustrim dhe vlerësim më të detajuar, faturën në fjalë e bashkëngjisim më poshtë:

Duke pasur parasysh mospërputhjet dhe parregullsitë e evidentuara më sipër, konsiderojmë se AK ka qenë i obliguar që të verifikojë në mënyrë të plotë dhe të kujdesshme autenticitetin e këtij dokumentacioni dhe, në mungesë të një verifikimi bindës, të konstatojë se operatori ekonomik i rekomanduar nuk ka arritur të dëshmojë përmbushjen e kërkesës përkatëse të Dosjes së Tenderit.

Kundërshtimi i arsyetimit të Autoritetit Kontraktues: AK përderisa refuzon këtë pretendim ankimor, ndër tjerash arsyeton se Komisioni i Vlerësimit nuk ka kompetencë të verifikojë aspektet fiskale apo tatimore të një fature dhe se, në mungesë të një vendimi të një organi kompetent që konstaton pavlefshmërinë e saj, dokumenti duhet të pranohet si i vlefshëm.

Megjithatë, pretendimi ynë ankimor nuk ka të bëjë me kryerjen e një auditimi fiskal apo me verifikimin e përputhshmërisë së faturës me legjislacionin tatimor, por me ekzistencën e dyshimeve serioze dhe objektive lidhur me autenticitetin, rregullsinë dhe besueshmërinë e dokumentit të paraqitur për të dëshmuar përmbushjen e një kërkesë të Dosjes së Tenderit.

Në rastin konkret, mospërputhja ndërmjet datës së lëshimit të faturës (10.07.2018) dhe numeracionit të saj (135/2016), si dhe mungesa e elementeve themelore të dokumentit, përbëjnë indicie objektive që kanë obliguar Autoritetin Kontraktues të kryejë verifikime shtesë për të vërtetuar autenticitetin dhe vlefshmërinë e dokumentacionit të paraqitur. Konkretisht LPP në nenin 52, paragrafi 7 saktësisht thekson se: **“Autoriteti kontraktues në rast të dyshimit të cilido informacioni të dorëzuar nga operatori ekonomik, do të kryejë një kontroll efektiv të informatave dhe dokumentacionit të tenderit”.**

Për rrjedhojë, Autoriteti Kontraktues nuk ka qenë i thirrur të konstatojë shkelje tatimore, por të verifikojë nëse dokumentacioni i paraqitur është i besueshëm dhe i mjaftueshëm për të provuar përmbushjen e kërkesave të Dosjes së Tenderit. Moskryerja e një verifikimi të tillë, përkundër dyshimeve të arsyeshme të ngritura, e bën të pambështetur konstatimin se operatori ekonomik i rekomanduar ka dëshmuar posedimin e pajisjes së kërkuar.

Pretendimi 4: Mungesa e dëshmive për dorëzimin e rregullt të Deklaratës nën Betim dhe Sigurimit të Tenderit nga OE i rekomanduar për kontratë

Deklarata nën Betim dhe Sigurimi i Tenderit përbëjnë dokumente themelore dhe obligative në kuadër të procedurave të prokurimit publik. Në rastin konkret, AK ka kërkuar dorëzimin e këtyre dokumenteve në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Dosjen e Tenderit.

Megjithatë, nga shqyrtimi i dokumentacionit të ofertës së operatorit ekonomik të rekomanduar për kontratë, "Rexha" SH.P.K., konkretisht nga analiza e Formularit të Dorëzimit të dokumenteve, nuk evidentohet se Deklarata nën Betim dhe Sigurimi i Tenderit janë dorëzuar si pjesë e ofertës.

Në veçanti, në Formularin e Dorëzimit, i cili paraqet listën e dokumenteve dhe dosjeve të bashkëngjitura nga operatori ekonomik, nuk figurojnë këto dy dokumente esenciale. Për më tepër, nga dymbëdhjetë (12) dokumentet/folderët e evidentuar në formularin përkatës, në asnjërin prej tyre nuk rezulton të jetë përfshirë apo identifikuar Deklarata nën Betim dhe Sigurimi i Tenderit.

Për ilustrim dhe vlerësim të këtij pretendimi, bashkëngjisim Formularin e Dorëzimit të operatorit ekonomik të rekomanduar:

Lista e dokumenteve të tenderit mbështetëse

Nr.	Dokument
1.	1.Dokumentet_e_biznesit.rar
2.	2.Referenca 1.rar
3.	3.Referenca 2.rar
4.	4.Referenca 3.zip
5.	5.Referenca 4.rar
6.	6.Referenca 5.rar
7.	7.Referenca 6.rar
8.	8.5 Stafi profesional.rar
9.	8.Stafi profesional.rar
10.	9.5 Makineria.rar
11.	9.Makineria.rar
12.	10.Stafi teknik.rar

Duke pasur parasysh rëndësinë e këtyre dokumenteve dhe faktin se mungesa e dorëzimit të tyre përbën shkak për refuzimin e ofertës, mbetet e paqartë se në çfarë mënyre AK ka konstatuar se operatori ekonomik i rekomanduar ka përmbushur këtë kërkesë.

AK përderisa përgjigjet në këtë pretendim të ngritur në Kërkesën për Rishqyrtim, të njëjtin e keqkupton tërësisht duke argumentuar se si neve na është ofruar qasje në këto dokumente. Këtë fakt ne nuk e kemi kontestuar, sepse është e vërtetë se qasja na është ofruar edhe në këto dy dokumente të OE-së së rekomanduar, mirëpo ne kemi kërkuar të dimë se si AK i ka siguruar këto dokumente, meqë të njëjtat nuk figurojnë në “Formularin e Dorëzimit”. Përderisa nuk kemi pranuar një përgjigje bindëse dhe të faktueshme se si AK i ka siguruar këto dy dokumente, ky pretendim mbetet plotësisht i qëndrueshëm.

Përfundimisht Komisioni i Vlerësimit ka bërë shkelje të Nenit 59 paragrafi 1 të LPP-së, pasi të njëjtit janë të obliguar që të vlerësojë dhe krahasojë tenderët e përgjegjshëm sipas kriterëve për dhënien e kontratës të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe Dosjen e Tenderit. Bazuar në nenin 27, paragrafi 1, lidhur me paragrafin 3 të RrPP-së në mënyrë shumë të qartë thuhet se: *“Nëse kriteri “tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët” është kriteri i vetëm, kontrata do të jepet për tenderin me çmim më të ulët që përmbushë kërkesat e specifikuar. Nëse kriteri është ‘tenderi ekonomikisht më i favorshëm’, kontrata duhet ti jepet tenderit i cili më së miri përmbushë kriteret relevante”*. Përkundër se ne plotësojmë të gjitha kërkesat dhe jemi OE i vetëm i përgjegjshëm, AK na ka shpallë OE të pasuksesshëm, duke rekomanduar për kontratë një OE i cili qartazi nuk ka përmbushur kërkesat e dosjes së tenderit dhe si i tillë është i papërgjegjshëm.

Komisioni i vlerësimit ka shkelur në mënyrë flagrante nenin 40, paragrafi 6 i RrPP-së, kur ka rekomanduar për kontratë OE-në Rexha SH.P.K.. Bazuar në këtë dispozitë, në mënyrë taksative potencohet se: *“Tenderi do të konsiderohet i përgjegjshëm kur:*

a. është në pajtueshmëri nga aspekti administrativ me kërkesat formale të dosjes së tenderit;

b. është në pajtueshmëri në termet teknike me përshkrimin, kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në dosje të tenderit;

c. është dorëzuar nga Operatori ekonomik që përmbush kriteret e përzgjedhjes të përcaktuara në dosje të tenderit”.

Gjithashtu Komisioni i Vlerësimit nuk ka respektuar nenin 40 të RrPP-së, konkretisht paragrafin 1, i cili kërkon që ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve të bëhet në pajtueshmëri me parimet themelore të përcaktuara me LPP. Pastaj paragrafin 13 i cili saktëson se: “Komisioni vlerësues do t'i vlerësojë dhe krahasojë tenderët e përgjegjshëm sipas kriterëve për dhënien e kontratës të përcaktuara në njoftimin e kontratës / dosjen e tenderit”

Gjithashtu Komisioni i Vlerësimit të AK-së ka shkelë edhe nenin 7 të LPP-së, ku në paragrafin 1 të nenit 7 parashihet qartë se: “Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do te veproje ne mënyrë transparente. Po ashtu paragrafi 6 i nenit 7 të LPP-së parasheh që: “Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë: (vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtësore të kushteve, kriterëve dhe specifikimeve përkatëse”, mirëpo AK nuk i është përmbajtur as kësaj dispozite ligjore.

Përtej këtyre, AK nuk e ka pasur në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Andaj, mbi bazën e provave dhe fakteve të theksuara më lartë, Organit Shqyrtues të Prokurimit i propozojmë që të marrë këtë:

V E N D I M

- I.** **APROVOHET** si e bazuar Ankesa e OE “ETEAAM SH.P.K”
- II.** **ANULOHET** Njoftimi mbi Vendimin e AK-së i datës 24.06.2026, ashtu që lënda kthehet në RIVLERËSIM.
- III.** Detyrohet AK që ankuesit OE “ETEAAM SH.P.K”, t’ia mbulojë shpenzimet e procedurës.
- IV.** Meqë ankesa e OE “ETEAAM SH.P.K” është e bazuar, bëhet kthimi i mjeteve të depozituara në emër të parashtrimit të ankesës.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

ETeam SH.P.K., deri në këtë fazë të procedurës i janë shkaktuar dëme të konsiderueshme të cilat konsistojnë në përgatitjen e aplikimit për tender, përgatitjen e mjeteve juridike për apelimin e vendimeve të kundërligjshme të AK-së. Andaj, në rast se OSHP nuk e kthen ligjshmërinë në këtë aktivitet, dëmet do të marrin dimension të paparashikueshëm për shkak të privimit nga e drejta për shpërbllim me kontratë, të cilat do të detyrohet AK t'i kompensoj.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,*
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*